



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**  
**BORDI I AKREDITIMIT**

**VENDIM**

**Nr. 06, datë 25.02.2022**

**PËR**

**MIRATIMIN E PYETËSORIT, MANUALIT DHE PLANIT TË VEPRIMIT ME AFATET  
KOHORE TË SONDAZHIT KOMBËTAR TË STUDENTËVE**

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e përgatitur nga Bordi i Akreditimit dhe ASCAL, në kuadër të realizimit të Sondazhit Kombëtar të Studentëve,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë pyetëSORIN e “Sondazhit Kombëtar të Studentëve”, të rradhës, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Të miratojë Manualin dhe Planin e Veprimit me afatet kohore për realizimin e “Sondazhit Kombëtar të Studentëve”, të rradhës, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin dhe publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.